



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.10419/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Nehat Idrizi - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Franciska Zhitia - Ymeri, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses: F.A. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson I.G., avokat në Prishtinë, sipas autorizimit, kundër të paditurës: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, (SHSKUK), me seli në Prishtinë, “Lagjja e Spitalit”, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar Teuta Islami, sipas autorizimit, për kompensimin e tri pagave jubilarë, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësueses së autorizuar të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4240/19, të datës 17.11.2020, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 17.05.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e përfaqësueses së autorizuar të paditurës: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës, (SHSKUK), me seli në Prishtinë, “Lagjja e Spitalit”, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4240/19, i datës 17.11.2020, në pikën I dhe II, të dispozitivit VËRTETOHET.

II. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën III, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.4240/19, të datës 17.11.2020, ka vendosur që të: I. Aprovohet pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses F.A. nga Prishtina. Në pikën II, të dispozitivit ka vendosur që të: Detyrohet e paditura Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, që paditëses në emër të tri pagave të shpërblimit jubilar t’ia paguaj shumën prej 1.413 €, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë datë 05.12.2020 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 259 €, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Në pikën III, të dispozitivit ka

vendosur që të: Refuzohet e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditëses mbi shumën e gjykuar dhe atë në shumë prej 620.21 €.

Kundër këtij aktgjykimi përfaqësuesja e autorizuar e të paditurës brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës si e bazuar dhe padia e paditëses të refuzohet si e pabazë.

Me përgjigje në ankesë i autorizuari i paditëses ka propozuar që ankesa e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të refuzohet si e pabazë dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet në tërësi si i bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësueses së autorizuar të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, përmes të autorizuarit të saj, me datë 05.12.2019, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, për kompensimin e pagave të shpërblimit jubilar, kundër të paditurës, të precizuar si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 17.11.2020, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë si të bazuar dhe të detyroj palën e paditur SHSKUK - QKUK që paditëses t'ia paguaj tri paga në emër të shpërblimit jubilar dhe atë në shumën prej 2,033.61 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.4240/19, të datës 17.11.2020, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës ushtruese e detyrës Kryeinfermiere e Shërbimit të Klinikës së Gastroenterologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe se e njëjta ka 38 vite përvojë pune si dhe fakti se e njëjta ka pagën bazë në shumë prej 471 €. Kjo vërtetohet edhe në bazë të kontratës së punës me numër 535 të datës 22.05.2017, vërtetimit për përvojën e punës 2019 si dhe listës së pagave - buxheti i Republikës së Kosovës. Nga provat e administruara gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, ngase është vërtetuar fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura dhe se e njëjta ka 38 vite përvojë pune dhe se e paditura nuk ia ka paguar paditëses shpërblimin jubilar në vlerën e tri pagave mujore edhe pse një obligim i tillë është paraparë me nenin 17 paragraf 3 nën paragraf 3.3 si dhe paragraf 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale, të lidhur nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 11.06.2018. Ka shtuar se e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditëses mbi shumën e gjykuar, sepse në bazë të listës

së pagave në të cilën është thirrur paditësja rezulton se në vlerën prej 677.87 € aq sa ka realizuar paditësja për një muaj është e përfshirë edhe kompensimi për kujdestari dhe shujtë, ndërsa sipas vërtetimit mbi përvojën e punës rezulton se paditësja ka pagë mujore në shumë prej 471 €.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 17 paragraf 3, pika 3.3 dhe 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale, nenit 245 paragraf 1 të LMD-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në nenin 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e pjesshme të kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestuese në mes palëve se paditësja ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune tek e paditura, nuk është kontestues fakti se paditësja ka përvojë pune 38 vite, si Kryeinfermiere në Klinikën Gastroenterologjisë me Hp.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se: me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...”.

Me nenin 17 paragraf 3, të Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë të datës 11.06.2018 përcaktohet se: “Punëtorët shëndetësor, në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë 3.1. për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një paga mujore të tij, 3.2. për 20 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të dy paga mujore të tij, 3.3. për 30 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij”, ndërsa me paragrafin 4 të këtij neni, përcaktohet se: “Punëdhënësi i fundit

është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të pjeshëm të kërkesëpadisë së paditëses, duke e detyruar të paditurën që paditëses ti paguaj tri paga për shpërblim jubilar me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të datës 11.06.2018, të lidhur dhe nënshkruar nga Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSHSK-së) dhe Ministrisë së Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 11.06.2018 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës dhe se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 paragraf 1 dhe 2 i LMD-së, me nr. 04/L-077 i datës 30.05.2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Pika III, e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar, në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë nuk është shqyrtuar sepse ankesa nuk ka qenë e drejtuar përkitazi me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 10419/21, me datë 17.05.2022

Kryetari i kolegjit
Nehat Idrizi, d.v